

FJALA E DEPUTETIT VANGJEL DULE

E HËNË 11 PRILL 2022

Të nderuar kolegë,

Zonja drejtuese,

Kjo seancë është e destinuar për deputetët, të cilët duhet t'i përcjellin ekzekutivit shqetësimet e zgjedhësve, të qytetarëve, nuk është një seancë për parada ministrash nga fitorja në fitore. Keni kapur gjithçka; keni kapur shtetin, keni kapur median. Edhe një seancë, që parashikohet për të krijuar një hapësirë pak më të madhe për shqetësimet shoqërore, edhe atë me mënyrën tuaj keni arritur ta kapni. Mirë që e bëni, por, të paktën na i kurseni hartimet. Kryeministri ka pajtuar një qerre me fjalimshkruet. Le të mos i konsumojë vetëm për vete. Lutuni edhe ju t'ju përgatisin ndonjë fjalim!

Zonja drejtuese,

Unë do të dëshiroja sot të ndaja një shqetësim të një komuniteti, i cili ka vetëm pergamenë pozitive në historinë e tij, është fshati Mursi në Jug të vendit, në qarkun e Vlorës, në Bashkinë e Konispolit. U kanë dërguar një peticion disa ministrave, të cilët flasim me entuziazëm për Këshillimin Kombëtar, një proces sovjetik në mentalitet. Më vjen keq që e dëgjoj atë edhe nga ministra të rinj, të cilët duhet t'i thonë një propozim racional Kryeministrit të tyre. Në demokraci operohet me referendume. Në Sovjetin e Leninit operohej me këshillime kombëtare; janë të natyrës partiake, nejtë. Rikthehem te peticioni, që u ka vajtur prej kohësh disa ministrave të qeverisë, nga komuniteti i Mursisë, të cilët heshtin pa u dhënë asnjë përgjigje, pa u dhënë asnjë zgjidhje. Cili është problemi? Cili është shqetësimi?

Një fshat, i cili është i shquar për produktet bujqësore, është destinacion i agroturizmit, është përzgjedhur nga vetë qeveria për programin e "100 fshatrave", po nëpërkëmbet me vendime të paligjshme të Bashkisë së Konispolit për të ngritur një objekt industrial krahas varrezave të tyre, aty ku nderojnë të parët e tyre. Ka tri shkelje: 1. Abrogohen aktet e vitit 1995 të marrjes së tokës në propozim, në kundërshtim të hapur me ligjin nr. 171 të vitit 2014. Janë tri vendime të këshillit bashkiak në kundërshtim dhe në sfidë të hapur me legjislacionin në fuqi. 2. Është një sakrilegj. Nuk mund të ngrihet një objekt industrial në krahas të varrezave të një komuniteti. 3. Nuk mund ta kesh, nga njëra anë, destinacion agroturistik, për shkak të bukurisë që i ka falur Perëndia dhe prosperitetit që i ka krijuar njerëzia, duke e prishur me objekte që nuk janë të natyrës, për të cilën ato janë përzgjedhur si një destinacion i tillë.

Prandaj, zonja dhe zotërinj, në vend që të na i përshkruani në mënyrë ditirambike iniciativat, në një kohë kur njerëzi po vuajnë pasojat e politikave tuaja, kthejuni vështrimin, shikojini njerëzit në sy, nëse ju pranojnë ende që t'i shikoni; zgjidhuni ndonjë hall dhe kujtojeni Kryeministrit se në Mursi ka qenë i mirëpritur nga bujaria e atyre qytetarëve, i ka lavdëruar ata publikisht, ndërsa sot i dhunon ata, të parët e tyre dhe perspektivën e tyre. Faleminderit!